



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:141572

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 04984739

C.nr. 1866/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve R.R, dhe A.H, qe të dyja nga Peja, të cilat i përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja, kundër të paditurës K.S.E. në Prishtinë, e përfaqësuar nga E.A, sipas autorizimit, me objekt kontesti zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 3,490.00 Euro, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.11.2023, ndërsa me datë 29.11.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve R.R dhe A.H, që të dyja nga Peja, ashtu që:

I. DETYROHET e paditura K.S.E në Prishtinë, që paditëseve R.R dhe A.H, qe të dyja nga Peja, në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e dt. 21.03.2021, tua paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Për paditësen R.R:

-në emër të dëmit jo material:

- për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike-trupore.....900.00 Euro.
- për të gjitha llojet e frikës së përjetuar1,000.00 Euro.

- në emër të dëmit material:

- për ushqim të përforcuar.....160.00 Euro.
- për ndihmë dhe kujdes të huaj.....100.00 Euro.

Për paditësen A.H:

-në emër të dëmit jo material:

- për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike-trupore.....700.00 Euro.
- për të gjitha llojet e frikës së përjetuar800.00 Euro.

- në emër të dëmit material:

- për ushqim të përforcuar.....70.00 Euro.
- për ndihmë dhe kujdes të huaj.....50.00 Euro.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR, kërkesë padia e paditëseve R.R dhe A.H, që të dyja nga Peja, përtej shumës së gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për aksidentin e dt. 21.03.2021, për shumat e specifikuar si më poshtë:

Për paditësen R.R:

- në emër të dëmit jo material:

- për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike-trupore.....700.00 Euro.
- për të gjitha llojet e frikës së përjetuar700.00 Euro.

- në emër të dëmit material:

- për ndihmë dhe kujdes të huaj.....100.00 Euro.
- për terapi fizikale.....250.00 Euro.

Për paditësen A.H:

- në emër të dëmit jo material:

- për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike-trupore.....700.00 Euro.
- për të gjitha llojet e frikës së përjetuar700.00 Euro.

- në emër të dëmit material:

- për ndihmë dhe kujdes të huaj.....50.00 Euro.
- për terapi fizikale250.00 Euro.

III. DETYROHET e paditura K.S.E në Prishtinë, që shumat e gjykuara, si në pikën I, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, tua paguaj paditëseve me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë sa i përket dëmit jo material duke filluar nga data nxjerrjes së këtij aktgjykimi 29.11.2023, ndërsa sa i përket dëmit material nga data e parashtrimit të padisë 01.07.2021, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura K.S.E në Prishtinë, që paditëseve R.R dhe A.H, që të dyja nga Peja, tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,241.80 Euro, e të gjitha këto, ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës K.S.E në Prishtinë, të njëjtën e kanë precizuar me parashtrësën e dt.17.11.2023, me objekt kontesti zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 3,490.00 Euro.

I autorizuari i paditëseve me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: me provat e administruara është vërtetuar në tërësi gjendja faktike si në padi, në këtë çështje kontestimore mes palëve ndërgjyqëse gjatë gjithë procedurës nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadiisë, por vetëm lartësia e dëmit. Lartësia e dëmit është vërtetuar me nxjerrjen e ekspertizave nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, përkatësisht ekzaminimit të drejtpërdrejtë që u është bërë paditëseve në seancë, shton se ka bere precizimin e kërkesëpadiisë duke u bazuar ne mendimin e eksperteve të lartcekur, mirëpo precizimin e ka bërë duke u bazuar ne udhëzuesin e Gj Supreme me nr 41/2023, te dt. 27.02.2023, i cili udhëzues parasheh kriteret për caktimin orientues dhe lartësinë e shpërblimit te të drejtës në të holla, për demin jo material. I propozoj gjykatës që të aprovohet padia dhe precizimi i saj si i bazuar me kamate ligjore nga dita e parashtrimit të padisë. Po ashtu i propozon gjykatës që edhe shpenzimet procedurale t'i aprovoj, dhe atë shumen 156,00 euro për përpilim e padisë, 21.00 euro për takse gjyqësore, 3 seanca te mbajtura nga 202.80 euro, dhe për precizimin e padisë 156,40 euro, si dhe pagesën për ekspert 2x150 ne total 300 euro.

I autorizuari i të paditurës se me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas nxjerrjes se ekspertizave mjekësorë është vërtetuar fakti se paditëset kane pësuar lëndime te lehta trupore andaj i propozojmë gjykatës qe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoj pjesërisht duke e kundërshtuar shumat e kërkuara me precizimin e dt. 17.10.2023, dhe duke gjykuar shuma dukshëm me te ulëta te cilat do te ishin ne harmoni me lëndimet e pësuar nga paditësi. Sa i përket fjalës përfundimtarë te cilën e pranova sot ne ketë seance te njëjtën e kundërshtojmë pasi qe edhe siç theksuam me larte pretendimet e palëve paditëse janë tejet te larta ne raport me lëndimet te cilat i kane pësuar ne aksidentin e dt. 21.03.2021, ndërsa lidhet me listën e shpenzimeve te cilën e dorëzoj këtu i autorizuari i paditësve, kërkojmë nga gjykata te vlerësoj sipas suksesit te procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: raportit i emergjencës me nr. Protokollit 4494 për R.R, udhëzimi për konsultim për R.R, letërnjoftimi kopje p.r A.H, raporti nga emergjenca me nr. Protokollit 443 për A.H, raporti fillestar i aksidentit ne dt. 2021-CFT-165 i dt. 21.03.2021, raporti i policit hetues me nr. 2021-CFT-165 i dt. 21.03.2021, mendimin e ekspertëve mjekësor nga lëmia e ortopedisë Dr.Florim Bajraktari – ortoped dhe lëmia e psikiatrisë Dr. Muhamet Halitaj – psikiatër, dhe deklarimet e përfaqësueseve të autorizuar te ndërgjyqësve.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 21.03.2021, rreth orës 15:00 minuta në fshatin Pjetërshticë, K.Shtime, kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor me fajin e vozitësit A.H, dhe se vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë me Polisë të Sigurimit, te këtu e paditura K.S.E në Prishtinë, për çka pala e paditur me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadsisë, mirëpo kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadsisë. Me nenin 321 të LPK-së parashihet se “Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”.

Meqenëse në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese baza juridike në raport me shkaktarin e aksidentit, gjykata nuk u lëshua në arsyetimin e provave në raport me shkaktarin e aksidentit.

Sipas dispozitës së nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “ në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit ”.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadsisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga Dr. Florim Bajraktari – ortoped, dhe Dr. Muhamet Halitaj – psikiatër, të cilët në mendimet e tyre të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.10.2023, janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që kanë pësuar paditëset si pasojë e këtij aksidenti.

Eksperti nga lëmia e ortopedisë Dr. Florim Bajraktari pas shikimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditëses R.R, në seancën e datës 13.10.2023, ka dhënë këtë konstatim se e njëjta ka pësuar ndrydhje qafe dhe të krahut të djathtë. Natyra e lëndimit: Lëndim i lehte trupor. Dhimbje fizike - dhimbje të intensitetit posaçërisht të larte 20 min, dhimbje të intensitetit të larte 3 ore, dhimbje të intensitetit të mesëm 3 javë, dhimbje të intensitetit të ulet ka edhe sot e kësaj kohe për shkak të ndryshimeve klimatike. Shëmtim trupor nuk ka. Ndihma dhe kujdesi i huaj 10 ditë ka qene i nevojshëm. Ushqimi i përforcuar 1 muaj. Rehabilitimi fizikal- ka pasur nevoje për se paku 2 jave terapi fizikale. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Ndërsa për paditësen A.H ka dhënë këtë konstatim se e njëjta ka pësuar ndrydhje qafe, trupit dhe të nyjës së dorës së majte. Natyra e lëndimit: Lëndim i lehte trupor Dhimbje fizike - dhimbje të intensitetit posaçërisht të larte 20-25 min, dhimbje të intensitetit të larte 2 ore, dhimbje të intensitetit të mesëm 10 dite, dhimbje të intensitetit të ulet 1 muaj. Shëmtim trupor nuk ka. Ndihma dhe kujdesi i huaj ka qene i nevojshëm 5 ditë. Ushqimi i përforcuar 2 javë. Rehabilitim fizikal se paku 10 dite terapi fizikale ka qenë e i nevojshëm. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka.

Eksperti nga lëmia e psikiatrisë Dr. Muhamet Halitaj pas shikimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditëses R.R, në seancën e datës

13.10.2023, ka dhënë këtë konstatim se njëjta ka përjetuar frike primare te intensitetit te larte ne kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhe është e përcjelle me shtangim afektiv dhe frike nga vdekja e drejtpërdrejt, frike sekondare me intensitet te larte ka pasur ne periudhën kohore gjer ne 3 ore, duke e llogaritur kohe nga momenti i aksidenti dërgimi i saj ne QKMF në Shtime, ku i janë bere ekzaminimet dhe rehabilitimi mjekësor. Kjo periudhe është percjellur me mundim te rrahura te shpejtuar te zemrës, dridhje te muskujve, frymëmarrje ete vështirësuar dhe ankesa te tjera trupore. Frike sekondare me intensitet te mesëm ka pasur ne periudhën kohore gjer ne 5 javë, te manifestuar me nje çrregullim te stabilitetit psiko-fizik si pasoje e aksidentit si In-disponim, pengesa te herëpashershme ne gjumë, rikujtim te ngjarjes traumatike, shkalle me te ulet te tolerantes frustrative, si dhe ankesa te tjera trupore. Frike sekondare me intensitet te ulet ka pasur ne periudhën kohore gjer ne tre muaj e qe eshte manifestuar gjate kohës se daljes ne komunikacion apo ngjarjet qe ia rikujtojnë aksidentin, ndërsa për paditësen A.H, ka dhënë këtë konstatim se e njëjta ka përjetuar frike primare te intensitetit te larte ne kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është e përcjelle me shtangim afektiv, frike sekondare te intensitetit te larte ka pasur ne periudhën kohore gjer ne 2 ore, te manifestuar me mundim, te rrahura te shpejtua te zemrës, frymëmarrje te vështirësuar, dridhje te muskujve dhe ankesa te tjera trupore. Frike sekondare me intensitet te mesëm ka pasur ne periudhën kohore gjer ne 4 jave te manifestuar me një çrregullim afektiv afatgjate si pasoje e aksidentit si: In-disponim, pengesa te herëpashershëm ne gjumë, rikujtim te ngjarjes traumatike, si dhe ankesa te tjera trupore. Frike sekondare me intensitet te ulet ka pasur ne periudhën kohore gjer ne tre muaj e qe është manifestuar gjate kohës kur ka dale ne komunikacion apo ngjarjet qe ia rikujtojnë aksidentin.

Gjykata në tersi ia ka falur besimin konstatimeve të eksperteve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe gjithashtu palët ndërgjyqëse pas deklarimit të eksperteve mjekësor nuk kanë pasur vërejtje në mendimin e tyre, për çka gjykata ia fali besimin e plotë mendimit të eksperteve.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishin pësuar paditëset në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës se përjetuar, sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët mjekësor, moshën e paditëseve, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditëset, e duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh më qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu

referuar paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror”. Pra, nga kjo dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballje të tejkalimit të pasojave që në këtë rast paditëset kanë pasur në aksidentin e datës 21.03.2021.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë të drejta për paditëset.

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Në këtë rast paditëseve iu takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, edhe përkundër faktit se paditëset për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloj dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditëset, kanë pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje, dhe ushqim të përforcuar, ku të njëjtave ju takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin jo material, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin material si ndihmë dhe kujdes të huaj, pasi që gjykata vlerëson se paditëset nuk e kanë argumentuar me asnjë provë kërkesën e tyre për pjesën e refuzuar të kërkesëpadiës si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kjo mbështetet edhe në dispozitën e nenit 7 të LPK-së, me të cilën shprehimisht parashihet se palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë

ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Ndërsa sa i përket kompensimit për terapi fizikale paditëset nuk kanë prezantuar asnjë provë të vetme në bazë të së cilës do të vërtetoheshin pretendimet e tyre që të iu kompensohet kjo kategori e dëmit material.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dëmin jo material pasi që konsideron se nga momenti i përpilimit të aktgjykimit (datë **20.11.2023**) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar, ndërsa sa i përket dëmit material gjykata konsideron se nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë (data 01.07.2021) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për dëmin e shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën III të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e palës paditëse në këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 1,241.40 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumë prej 156 euro, taksën për padi shumë prej 21 euro, për ekspertiza mjekësore të ekspertëve mjekësor shumë prej 2x150=300 euro, për tri seanca të mbajtura për secilën nga 608.40 x 3=608.40 euro, dhe shumen 156 euro për precizimin e kërkesëpadisë).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:141572 - C.nr.1866/21, 29.11.2023

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimin, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.